



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

STATUTI I FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE¹

STATUTE OF THE HEALTH INSURANCE FUND²

STATUT FONDA ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE³

¹ Statuti i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, është miratuar në mbledhjen e 118 -të Qeverisë së Republikës së Kosovës , me vendim Nr. 08/118 dt 30.11.2016

² Statute of the Health Insurance Fund, was approved in the 118-meeting of the Government of Republic of Kosova, with the decision no.08/118dt. 30.11.2016

³ Statut Fonda za Zdravstveno Osiguranje, usvojenje na 118 oj , sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br.08/118 dt 30.11.2016

| | | |
|--|---|--|
| <p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore, nenit 19 paragrafi 6.2 të Rregullores Nr. 09/2011 (GZ , Nr 15, 12.09.2011) të Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 26 të Ligjit Nr. 04 / L - 249 për Sigurim Shëndetësor;</p> <p>Miraton:</p> <p>STATUTIN E FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky Statut përcakton organizimin, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (në vijim "Fondi").</p> | <p>Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of Republic of Kosovo, article 34 paragraph 1 of the Law no. 03/L-189 on State Administration, article 19 paragraph 6.2 of Regulation no. 09/2011 (OG, no. 15, 12.09.2011) on work of the Government of Republic of Kosovo, article 26 of Law no. 04 / L – 249 on Health Insurance;</p> <p>Approves:</p> <p>STATUTE OF THE HEALTH INSURANCE FUND</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This statute sets forth organization, rights, obligations, responsibilities and way of performance of activities of the Health Insurance Fund (hereinafter: "Fund").</p> | <p>Vlada Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova, člana 34. stav 1. Zakona br.03 / L - 189 o državnoj upravi, člana 19 stav 6.2 Poslovnika o radu Vlade Republike Kosova br.09 / 2011 (Službeni list br.12.09.2911) , člana 26. Zakona o zdravstvenom osiguranju br. 04-L-249, Vlada Republike Kosova;</p> <p>Usvaja:</p> <p>STATUT FONDA ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Svrha</p> <p>Ovaj Statut utvrđuje organizovanje, prava, dužnosti i odgovornosti i način obavljanja delatnosti Fonda za zdravstveno osiguranje (u daljem tekstu" Fond").</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Ky Statut zbatohet për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, Bordin Drejtues dhe stafin e Fondit.</p> | <p style="text-align: center;">Article 2 Scope of implementation</p> <p>This Statute is implemented for the Health Insurance Fund, Managing Board and staff of the Fund.</p> | <p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug primene</p> <p>Ovaj Statut se primenjuje za Fond zdravstvenog osiguranja, Upravni odbor i osoblje Fonda.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizime</p> <p>Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë të njëjtin kuptim të përcaktuar në Ligjin për Sigurimin Shëndetësor Nr. 04 / L-249 (në vijim "Ligji mbi Sigurimin Shëndetësor").</p> | <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>All terms used in this Statute have the same meaning provided by the Health Insurance Law No. 04 / L-249 (hereinafter: "Health Insurance Law").</p> | <p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>Svi izrazi upotrebljeni u ovom Statutu imaju isto značenje kao što je definisano Zakonom o zdravstvenom osiguranju br. 04 / L-249 (u daljem tekstu: "Zakon o zdravstvenom osiguranju").</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 4 Statusi Ligjor i Fondit</p> <p>1. Në pajtim me Ligjin për Sigurimin Shëndetësor Fondi është institucion publik i sigurimit shëndetësor me statusin e personit juridik me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatimin e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor dhe të akteve tjera relevante nënligjore, në emër të siguruarve, përfshirë mbledhjen efektive të mjeteve financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 4 Legal status of the Fund</p> <p>1. Pursuant to Health Insurance Law, the Fund is a public health insurance institution, in capacity of a legal entity with special rights, obligations, responsibilities and authorizations for implementation of the Health Insurance Law and other relevant sublegal acts, on behalf of the insured persons, including effective collection of financial means for provision of health care services by health care institutions in all types of ownership.</p> | <p style="text-align: center;">Član 4 Pravni status Fonda</p> <p>1. U skladu sa Zakonom o zdravstvenom osiguranju, Fond je javna ustanova zdravstvenog osiguranja sa statusom pravnog lica sa pravima, obavezama, odgovornostima i posebnim ovlašćenjima u primeni Zakona o zdravstvenom osiguranju i drugih relevantnih podzakonskih akata, u ime osiguranika, koje uključuje efikasno prikupljanje finansijskih sredstava u pružanju zdravstvenih usluga od strane zdravstvenih ustanova svih oblika svojine.</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>2. Emri i Fondit është Fondi për Sigurime Shëndetësore i Kosovës. Fondi ka të drejtën ekskluzive për emrin e tij.</p> <p>3. Fondi është institucion publik i një interesi të veçantë publik me seli në Prishtinë.</p> <p>4. Në funksionimin ligjor Fondi merr të drejtat dhe përgjegjësitë, është pronar i asetëve financiare dhe pasurive të patundshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij të ofrimit të sigurimeve, dhe është palë në procedurat para gjykatave ose organeve të tjera shtetërore.</p> <p>5. Fondi në harmoni me ligjin për vula do të ketë vulën dhe shenjën njohëse të cilat do të përdoren për komunikimet zyrtare në aktivitetet e përditshme.</p> <p>6. Fondi i nënshtrohet menaxhimit të sektorit publik financiar dhe legjislacionit, si dhe rregullave të prokurimit publik.</p> | <p>2. Name of the Fund is: Kosovo Health Insurance Fund. The Fund has the exclusive right for its name.</p> <p>3. The Fund is a public institution of a special public interest with its seat in Pristina.</p> <p>4. Under legal functioning the Fund receives rights and responsibilities, is owner of financial assets and immovable properties related to its activity for provision of insurances and is a party in the proceedings before the courts and other state bodies.</p> <p>5. The Fund in accordance with law on stamps will have a stamp and signs for recognition which will be used for official communications in daily activities.</p> <p>6. The Fund is subject to management of financial public sector and legislation, as well as rules of public procurement.</p> | <p>2. Naziv Fonda je: Fond za zdravstveno osiguranje Kosova. Fond ima ekskluzivno pravo u vezi svog naziva.</p> <p>3. Fond je javna ustanova od posebnog interesa sa sedištem u Prištini.</p> <p>4. U zakonskoj funkciji Fond ima prava i odgovornosti, vlasnik je finansijske aktive i nepokretne imovine koje se odnose na njegovu delatnost pružanja osiguranja, i stranka je u procedurama ispred sudskih i ostalih državnih organa.</p> <p>5. Fond u skladu sa Zakonom o pečatima ima svoj pečat i prepoznatljiv znak koji će se koristiti u zvaničnoj komunikaciji tokom svakodnevnih aktivnosti.</p> <p>6. Fond podleže zakonodavstvu i pravilima menadžiranja finansijskog javnog sektora, kao i propisima za javne nabavke.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 5 Organet Drejtuese të Fondit</p> <p>1.Fondi drejtohet nga Bordi Drejtues (më tutje "Bordi) si organ më lartë vendimmarrës i Fondit, në pajtim me Ligjin për Sigurim Shëndetësor.</p> <p>2.Drejtori i Fondit (më poshtë "Drejtori") është përgjegjës për funksionimin e përditshëm të Fondit.</p> | <p style="text-align: center;">Article 5 Governing Bodies of the Fund</p> <p>1. The Fund is directed by the Steering Board (hereinafter: "Board") as the highest decision making body of the Fund, in accordance with the Law on Health Insurance.</p> <p>2. Director of the Fund (hereinafter: "Director) is responsible for the daily functioning of the Fund.</p> | <p style="text-align: center;">Član 5 Upravni organi Fonda</p> <p>1. Fondom upravlja Upravni odbor (u daljem tekstu: "Odbor") koji je najviši organ za donošenje odluka Fonda, u skladu sa Zakonom o zdravstvenom osiguranju.</p> <p>2. Direktor Fonda (u daljem tekstu:"direktor") je odgovorno lice za svakodnevno funkcionisanje Fonda.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 6 Përbërja e Bordit</p> <p>1. Në përputhje me Ligjin për Sigurimin Shëndetësor, Bordi Drejtues përbëhet nga tetë (8) anëtarë.</p> <p>1.1.Ministri i Shëndetësisë Kryesus i Bordit;</p> <p>1.2.Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij;</p> <p>1.3.Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ose përfaqësuesi i tij;</p> <p>1.4.Kryesuesi ose Përfaqësuesi i Odës së profesionistëve shëndetësorë;</p> | <p style="text-align: center;">Article 6 The Board composition</p> <p>1. In accordance with the Health Insurance Law, the Steering Board is composed of eight (8) members:</p> <p>1.1.The Minister of Health Chairperson of the Board;</p> <p>1.2.The Minister of Finance or his representative;</p> <p>1.3.The Minister of Labor and Social Welfare or his representative;</p> <p>1.4.Chairman or representative of the Chamber of Healthcare Professionals;</p> | <p style="text-align: center;">Član 6 Sastav Odbora</p> <p>1. U skladu sa Zakonom o zdravstvenom osiguranju,Upravni odbor se sastoji od osam (8) članova:</p> <p>1.1.Ministar zdrastva Predsedavajućeg Odbora;</p> <p>1.2.finansija ili njegov predstavnik;</p> <p>1.3.Ministar rada i socijalne zaštite ili njegov predstavnik;</p> <p>1.4.Predsedavajući ili predstavnik Komore zdravstvenih stručnjaka;</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.5. Kryesuesi i Bordit ose Përfaqësuesi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës;</p> <p>1.6. Kryesuesi ose përfaqësuesi i drejtorateve të Shëndetësisë të Asociacionit të Komunave të Kosovës;</p> <p>1.7. Përfaqësuesi i Shoqatave të Pacientëve;</p> <p>1.8. Drejtori i Fondit ose përfaqësuesi i tij, në rolin e Sekretarit të Bordit Drejtues, me të drejtë fjale por pa të drejtë vote.</p> <p>2. Bordi Drejtues mund të emërojë ekspertë vendor dhe ndërkombëtar në cilësinë e anëtarëve vëzhgues të Bordit Drejtues për mbështetjen e punës së tij në lidhje me çështjet specifike.</p> <p>3. Anëtarët e Bordit emërohen nga Qeveria me propozim të institucioneve përkatëse nga paragrafi 1 i këtij neni.</p> <p>4. Bordi ka mandat tre (3) vjeçar dhe anëtarët mund të rizgjidhen për aq kohë sa janë përfaqësues të organeve përkatës.</p> | <p>1.5. President of the Board or representative of the University Hospital and Clinical Service of Kosovo;</p> <p>1.6. Chairman or representative of the directories of healthcare of the Association of the Kosovo Municipalities;</p> <p>1.7. Representative of the Patients Associations;</p> <p>1.8. The Director of the Fund or his representative, in the role of the Secretary of the Steering Board, with no voting right.</p> <p>2. The Steering Board can appoint national and international experts as observer members of the Steering Board to support its work with regard to specific issues.</p> <p>3. The members of the Steering Board are appointed by the Government on the proposal of respective institutions from paragraph 1 of this Article.</p> <p>4. The Steering Board has a three (3) year mandate and the members can be re-elected as long as the representative is a member of the relevant body.</p> | <p>1.5. Predsedavajući Odbora ili predstavnik Univerzitetske bolničke i kliničke službe Kosova;</p> <p>1.6. Predsedavajući ili predstavnik Direktorata zdravstva asocijacija opština Kosova;</p> <p>1.7. Predstavnik udruženja pacijenata;</p> <p>1.8. Direktor Fonda ili njegov predstavnik, u svojstvu sekretara Upravnog odbora, bez prava glasa.</p> <p>2. Upravni Odbor može imenovati nacionalne i međunarodne stručnjake u svojstvu članova posmatrača Upravnog odbora za podršku njegovom radu u vezi specifičnih pitanja.</p> <p>3. Članove Odbora imenuje Vlada na predlog relevantnih institucija iz stava 1 ovog člana.</p> <p>4. Odbor ima trogodišnji (3) mandat i njegovi članovi mogu biti ponovo izabrani sve dok su predstavnici relevantnih organa.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>5. Bordi kryesohet nga Kryesuesi me mandat një (1) vjeçar, të zgjedhur në bazë të parimit të rotacionit.</p> <p>6. Bordi funksionon sipas legjislacionit që rregullon funksionimin e Bordeve Ekzekutive të Ndërmarrjeve Publike në nivel qendror sipas ligjit.</p> <p>7. Të gjithë anëtarët e Bordit të kontribuojnë në zbatimin efikas, transparent dhe me kohë të funksioneve dhe përgjegjësi të Bordit. Për këtë qëllim, të gjithë anëtarët e Bordit do të marrin pjesë aktivisht në punën e Bordit.</p> <p>8. Secili anëtar i Bordit që nuk vepron në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, mund të qortohet nga kryesuesi i Bordit deri në tre (3) herë në formë të shkruar. Në qoftë se e njëjta situatë vazhdon, Kryesuesi mund ta dërgojë çështjen për diskutim në Qeveri.</p> | <p>5. The Steering Board is chaired by the Chairman with one (1) year mandate, elected based on the principle of rotation.</p> <p>6. Steering Board shall function based on the legislation that regulates functioning of the Executive Boards of Public Enterprises at the central level in accordance with the Law.</p> <p>7. All members of the Board shall contribute towards effective, transparent and timely implementation of functions and responsibilities of the Board. For this purpose, all members of the Board shall participate actively with the Board's work.</p> <p>8. Any Board member failing to act in accordance with paragraph 7 of this Article will be reprimanded by the Board Chairman up to three (3) times in writing. If the same situation continues, the Chairman may address the issue for discussion to the Government.</p> | <p>5. Odborom rukovodi predsedavajući uz jednogodišnji (1) mandat, izabran po principu rotacije.</p> <p>6. Odbor funkcioniše u skladu sa zakonodavstvom koje uređuje funkcionisanje izvršnih odbora javnih preduzeća na centralnom nivou prema zakonu.</p> <p>7. Svi članovi Odbora pružaju doprinos u efikasnom, transparentnom i blagovremenom sprovođenju odgovornosti i funkcionisanja Odbora. Radi ostvarenja ovog cilja, svi članovi Odbora moraju biti aktivni učesnici u njegovom radu.</p> <p>8. Svaki član Odbora koji ne deluje u skladu sa stavom 7 ovog člana, može primiti tri (3) pismene opomene od strane predsedavajućeg Odbora. Ukoliko se nastavila ista situacija, predsedavajući može dostaviti Vladi ovaj slučaj na razmatranje.</p> |
|---|--|---|

| <p align="center">Neni 7 Detyrat dhe Përgjegjësitë e Bordit</p> | <p align="center">Article 7 Board duties and responsibilities</p> | <p align="center">Član 7 Dužnosti i odgovornosti Odbora</p> |
|---|--|---|
| <p>1. Në bazë të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor Bordi ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p>1.1.Propozon Statutin e Fondit për miratim në Qeveri;</p> <p>1.2.Zgjedhë dhe emëron Drejtorin e Fondit bazuar në konkursin publik;</p> <p>1.3.Shkarkon Drejtorin e Fondit për shkaqet e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi;</p> <p>1.4.Nxjerr Deklaratën Vjetore Financiare.</p> <p>2. Përgjegjësitë e tjera të Bordit Drejtues përfshijnë:</p> <p>2.1. Mbështet hartimin dhe miraton planin strategjik tre (3) vjeçar të Fondit, duke përfshirë planin buxhetor, planin e prokurimit dhe strategjinë e investimeve kapitale;</p> | <p>1. Pursuant to Law on Health Insurance, the Board has the following duties and responsibilities:</p> <p>1.1.proposes the Statute of the Fund for approval to the Government;</p> <p>1.2.Elects and nominates the Director of the Fund based on a public vacancy announcement.</p> <p>1.3.dismisses the Director of the Fund for reasons as provided by legal provisions in force;</p> <p>1.4.Issues Annual Financial Statements.</p> <p>2. Other responsibilities of the Steering Board include:</p> <p>2.1. supports drafting and approves the three (3) year strategic plan of the Fund, including budget plan, procurement plan and strategy of capital investments;</p> | <p>1. Na osnovu Zakona o zdravstvenom osiguranju Upravni Odbor ima sledeće dužnosti i odgovornosti:</p> <p>1.1.predlaže Statut Fonda Vladi na usvajanje;</p> <p>1.2.bira i imenuje direktora Fonda na osnovu javnog Konkursa;</p> <p>1.3.smenjuje direktora Fonda na osnovu razloga predviđenih zakonskim odredbama na snazi;</p> <p>1.4.Izdaje Godišnju finansijsku izjavu.</p> <p>2.Ostale odgovornosti Upravnog o uljučuju:</p> <p>2.1. podržava izradu i usvajanje trogodišnjeg (3) strateškog plana Fonda,uključujući budžetski plan, plan za nabavke i strategiju kapitalnih investicija;</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>2.2. Miraton kriteret e kontratave me ofruesit e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë standardet e cilësisë që duhet të përmbushen;</p> <p>2.3. Miraton kontratat me ofruesit e kujdesit shëndetësor në vlerë mbi 500, 000 euro, pas propozimit nga Drejtori;</p> <p>2.4. Miraton orarin e pagesave të punonjësve të Fondit, duke përfshirë atë të Drejtorit mbi bazën e kostos së operimit dhe mirëmbajtjes të Fondit të parashikuar në buxhetin e miratuar nga Bordi;</p> <p>2.5. Me propozimin e Drejtorit, miraton dhe themelon Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në lidhje të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm;</p> <p>2.6. Me propozimin e Drejtorit, miraton krijimin e degëve regjionale të Fondit;</p> <p>2.7. Miraton krijimin e komisioneve teknike dhe pagesat e anëtarëve të tyre, me propozim të Drejtorit;</p> <p>2.8. Deleton funksione operative dhe autorizime për Drejtorin e Fondit, sipas nevojës</p> | <p>2.2. approves criteria of contracts with healthcare providers, including quality standards which shall be fulfilled;</p> <p>2.3. approves contracts with healthcare providers in amount of over 500,000 euro, after proposal of the Director;</p> <p>2.4. approves timetable of payments for the Fund’s employees, including for the Director, on the basis of operational and maintenance cost of the Fund, foreseen with budget approved by the Board;</p> <p>2.5. by proposal of the Director, it approves and establishes the Commission for review of the appeals related to mandatory health insurance;</p> <p>2.6. by proposal of the Director, it approves establishment of regional branches of the Fund;</p> <p>2.7. approves establishment of the technical commissions and payments of their members, by proposal of the Director;</p> <p>2.8. delegates operational functions and authorizations to the Director of the Fund, as needed</p> | <p>2.2. usvaja kriterije za ugovore sa pružaocima zdravstvene zaštite, uključujući standarde kvaliteta koji trebaju biti ispunjeni;</p> <p>2.3.usvaja ugovore sa pružaocima zdravstvene zaštite u iznosu preko 500.000 evra, nakon predloga direktora;</p> <p>2.4.usvaja raspored isplata za zaposleno osoblje Fonda, uključujući direktora, na osnovicu operativnih troškova održavanja Fonda predviđenih budžetom usvojenog od strane Odbora;</p> <p>2.5.na predlog direktora, usvaja i formira Komisiju za razmatranje žalbi u vezi sa obaveznim zdravstvenim osiguranjem;</p> <p>2.6.na predlog direktora, usvaja formiranje regionalnih ogranaka Fonda;</p> <p>2.7.usvaja formiranje tehničkih komisija i plaćanje njihovih članova, na predlog direktora;</p> <p>2.8.delegira operative funkcije i ovlašćenja za direktora Fonda, prema potrebi.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 8 Roli Mbikëqyrës i Bordit</p> <p>Roli Mbikëqyrës i Bordit bëhet në pajtim me nenin 32 të Ligjit për Sigurime Shëndetësor.</p> | <p style="text-align: center;">Article 8 Supervisory role of the Board</p> <p>The Supervisory Board's role is done in accordance with Article 32 of the Law on Health Insurance.</p> | <p style="text-align: center;">Član 8 Uloga Nadzornog odbora</p> <p>Nadzorna uloga Odbora vrši se u skladu sa članom 32 Zakona o Zdravstvenom Osiguranju.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 9 Sekretariati i Bordit</p> <p>Rolin e sekretariatit të Bordit në koordinim me Kryesuesin dhe Drejtorin e Fondit, e kryen zyra e Drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.</p> | <p style="text-align: center;">Article 9 Board Secretariat</p> <p>Role of the Board Secretariat in coordination with the Chairman and Director of the Fund shall be carried out by the Director of the Health Insurance Fund.</p> | <p style="text-align: center;">Član 9 Sekretarijat Odbora</p> <p>Ulogu sekretarijata Odbora, u koordinaciji sa predsedavajućim i direktorom fonda, obavlja kancelarija direktora Fonda za zdravstveno osiguranje.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 10 Takimet e Rregullta të Bordit</p> <p>1. Bordi do të takohet së paku një (1) herë në muaj. Kryesuesi do të caktojë datat e takimeve në koordinim me Drejtorin e Fondit.</p> <p>2. Kryesuesi, ose ndonjëri prej anëtarëve të Bordit, mund të propozojë një takim emergjent duke dërguar një njoftim me shkrim me postë, faks ose postë elektronike për të gjithë anëtarët e tjerë, ku do të përfshijë arsytet dhe temat e</p> | <p style="text-align: center;">Article 10 Board's regular meetings</p> <p>1. The Board shall convene minimum once (1) per month. The Chairman shall schedule meeting dates in coordination with the Director of the Fund.</p> <p>2. The Chairman, or one of the Board members, may propose urgent meeting by notifying in writing via mail, facsimile or email all other members, to include reasons and proposed subjects for the meeting. Request for urgent</p> | <p style="text-align: center;">Član 10 Redovni sastanci Odbora</p> <p>1. Odbor se sastaje najmanje jedanput (1) mesečno. U koordinaciji sa direktorom Fonda predsedavajući određuje datume sastanka.</p> <p>2. Predsedavajući, ili jedan od članova Odbora, može predložiti hitan sastanak uz poslato pismeno obaveštenje preko pošte, faksa ili elektronske pošte svim članovima odbora, u kojem naglašava razloge i predložene teme</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>propozuara për takim. Kërkesa për takim emergjent duhet të bëhet të paktën pesë (5) ditë para datës së mbledhjes së kërkuar.</p> <p>3. Në rastet kur Kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e tjerë të pajtohen, Bordi mund të takohet në më pak se pesë (5) ditë nga data e kërkesës për takim.</p> <p>4. Pagesa për anëtarët e Bordit dhe Sekretarisë do të bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Transparenca e Takimeve</p> <p>Takimet e Bordit janë të hapura për publikun, përveç nëse natyra e çështjes që do të diskutohet kërkon të trajtohet si konfidenciale. Individë të caktuar mund të ftohen në takime kur është e nevojshme ose e përshtatshme për natyrën e çështjeve që do të diskutohen.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Mbledhjet, kuorumi dhe vendimet e Bordit</p> <p>1. Për të mbajtur një takim formal, në mënyrë që Bordi të mund të marrë vendime, prania e Kryesuesit ose të deleguarit të tij si dhe së paku katër (4) anëtarë tjerë të Bordit me të drejtë vote është e nevojshme.</p> | <p>meeting shall be made minimum five (5) days before the requested meeting is held.</p> <p>3. In cases when the Chairman and all other members agree, the Board may convene minimum five (5) days from the date when the request for meeting was made.</p> <p>4. Payment for board members and the Secretariat shall be under the legal provisions in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Transparency of the meeting</p> <p>The Board's meetings are open for the public, except if the nature of the matter for discussion requires to be treated as confidential. The appointed individuals may be called in meetings when necessary or convenient for the nature of matters to be discussed.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Meetings, quorum and decisions of the Board</p> <p>1. To convene a formal meeting, in order the Board to render decisions, the presence of the Chairman or his delegate and of minimum other four (4) members of the Board with the right to vote, is required.</p> | <p>sastanka. Zahtev za hitan sastanak mora biti dostavljen najmanje pet (5) dana pre datuma predviđenog sastanka.</p> <p>3. U slučaju kada su se složili predsjedavajući i svi članovi, Odbor se može sastati i ranije od pet (5) dana od datuma predviđenog sastanka.</p> <p>4. Plaćanje članova odbora i Sekretariata će biti u skladu sa važećim zakonskim odredbama.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Transparentnost sastanaka</p> <p>Sednice Odbora su otvorene za javnost, osim u slučaju kada pitanje o kome se diskutuje zahteva konfidencijalnost. Određeni pojedinci mogu biti pozvani na sastanke ukoliko je neophodno i u skladu sa prirodom pitanja o kome se diskutuje.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Sastanci, kvorumi i odluke Odbora</p> <p>1. Da bi se održao formalni sastanak, na kome Odbor može da donose odluke, neophodno je prisustvo predsjedavajućeg ili njegovog zastupnika i najmanje četiri (4) člana Odbora sa pravom glasa.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>2. Vendimi merret kur shumica e anëtarëve votues të miratojnë propozimin. Në rast të votimit të barabartë, në të cilin ekziston një numër i barabartë i votave për dhe kundër propozimit, vota e Kryesuesit do të jetë vendimtare.</p> <p>3. Anëtarët e Bordit të cilët nuk janë në gjendje për të marrë pjesë në takimin e caktuar, duhet të informojnë menjëherë Kryesuesin dhe Drejtorin e Fondit për pamundësinë e pjesëmarrjes, duke arsyetuar mungesën e tyre.</p> <p>4. Nëse Kryesuesi konstaton se kushtet e kuorumit nuk janë plotësuar për një takim të planifikuar, ai/ajo do të informojë menjëherë me shkrim të gjithë anëtarët e Bordit në lidhje me anulimin e takimit.</p> <p>5. Bordi i merr vendimet me shumicë votash. Në mungesë të kuorumit, anëtarët e Bordit të cilët janë të pranishëm mund të diskutojnë në lidhje me çështje që lidhen me funksionet dhe përgjegjësitë e Bordit, por ata nuk mund të marrin vendime.</p> <p>6. Çdo anëtar i Bordit, i pranishëm në takim, mund të kërkojë votim mbi çdo çështje apo propozim. Anëtarët mund të votojnë për, kundër apo të abstenojnë.</p> | <p>2. Decision shall be rendered when majority of the voting members adopt the proposition. In case of equal voting, constituting equal number of votes pro and contra proposition, the vote of the Chairman shall be decisive one.</p> <p>3. Board members who are not able to participate the scheduled meeting, shall immediately inform the Chairman and Director of the Fund for being not able to attend, and justify their absence.</p> <p>4. If the Chairman maintains that the quorum conditions have not been fulfilled for the planned meeting, he/she shall immediately inform in writing all members of the Board, concerning cancellation of the meeting.</p> <p>5. The Board shall render decisions by majority votes. Lacking quorum, members of the Board present at the meeting may discuss on matters which are related to functions and responsibilities of the Board, but they may not render decisions.</p> <p>6. Any member of the Board, present at the meeting, may ask for voting on every matter or proposal. Members may vote pro, contra or abstain.</p> | <p>2. Odluka se donosi kada većina članova glasa za predlog. U slučaju jednakog broja glasova, u kojem postoji jednak broj glasova za i protiv predloga, glas predsjedavajućeg će biti odlučujući.</p> <p>3. Članovi odbora koji nisu u mogućnosti da prisustvuju zakazanom sastanku, moraju odmah obavesti predsjednika i direktora Fonda o nemogućnosti njihovog učestvovanja, opravdavajući njihov izostanak.</p> <p>4. Ako predsjedavajući utvrdi da nisu ispunjeni uslovi za planirani sastanak, on / ona će odmah pismeno obavestiti sve članove Upravnog odbora u vezi sa otkazivanjem sastanka.</p> <p>5. Odbor donosi odluke većinom glasova. U nedostatku kvoruma, članovi Odbora koji su prisutni mogu da raspravljaju o pitanjima koja se odnose na funkcije i odgovornosti Odbora, ali oni ne mogu da donose odluke.</p> <p>6. Svaki član Upravnog odbora prisutan na sastanku može zatražiti glasanje o bilo kom pitanju ili predlogu. Članovi mogu glasati za, protiv ili mogu biti uzdržani.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>7. Nëse Kryesuesi e konsideron të nevojshme dhe nëse natyra e vendimit është urgjente, anëtarët e Bordit të mund të votojnë në mënyrë elektronike. Në raste të tilla, Kryesuesi do të njoftojë me email të gjithë anëtarët e Bordit në lidhje me temat që do të trajtohen, dhe të kërkojë nga ata, me e-mail, miratimin e tyre për hapat e mëtejshëm. Nëse pas pesë (5) ditëve nga data kur email-i është dërguar, anëtari i Bordit që nuk i përgjigjet email-it të Kryesuesit, vota e tij/saj do të konsiderohet si "pajtim" për veprimin ose vendimin e propozuar.</p> <p>8. Në çdo kohë gjatë takimeve, Kryesuesi do të mbështetet dhe këshillohet nga Drejtori i Fondit për të siguruar efikasitetin e takimeve.</p> | <p>7. If the Chairman deems necessary and the nature of decision is urgent, members of the Board may vote in electronic form. In such cases, the Chairman shall notify via email all members of the Board on issues to be treated, and will request their approval via email for further steps. If after five (5) days from the date when the email was sent, the Board member does not reply to email of the Chairman, his/her vote shall be considered as "agreed" for the proposed action or decision.</p> <p>8. At all time during the meetings, the Chairman will be supported and instructed by the Director of the Fund to ensure effectiveness of the meetings.</p> | <p>7. Ako predsedavajući smatra neophodnim i ako je odluka hitne prirode, članovi Odbora mogu glasati elektronskim putem. U takvim slučajevima, predsedavajući će obavestiti putem e-maila sve članove Upravnog odbora u vezi sa tretiranim temama, i zahtevati putem e-maila njihovo odobrenje za dalje korake. Ukoliko član Odbora ne odgovori na primljeni e-mail, nakon pet (5) dana od dana kada je dostavljen e-mail, njegov / njen glas će se smatrati kao "pristanak" na predložene akcije ili odluke.</p> <p>8. Kako bi se osigurala efikasnost sastanka, u bilo kom trenutku tokom sastanka, predsedavajući će biti podržan i savetovan od strane direktora Fonda.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 13 Konflikti i Interesit</p> | <p style="text-align: center;">Article 13 Conflict of interest</p> | <p style="text-align: center;">Član 13 Sukob interesa</p> |
| <p>1. Në çdo takim, Kryesuesi do t'u përkujtojë anëtarëve të Bordit se, në qoftë se një anëtar ballafaqohet me konflikt interesi, atij/ asaj do t'i kërkohet që menjëherë të zbulojë faktet që çuan në konflikt, të lëshojë takimin dhe të mos marr pjesë në ndonjë prej takimeve dhe votimin e ardhshëm që ka të bëjnë me çështje ku konsiderohet se ka një konflikt interesi.</p> | <p>1. At every meeting, the Chairman shall remind Board members, in case of facing the conflict of interest, that he/she is required to immediately disclose facts which led to a conflict, abandon the meeting and cancel participation to future meetings and voting on matters which are considered to involve a conflict of interest.</p> | <p>1. Na svakom sastanku, predsedavajući podseća članove Odbora da će član koji je suočen sa sukobom interesa biti u obavezi da odmah otkrije činjenice koje su dovele do sukoba interesa, od njega-nje će zahtevati da napusti sastanak i neće prisustvovati nijednom sastanku i predstojećem glasanju koji ima veze sa pitanjima koja se smatraju kao sukobi interesa.</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>2. Çdo anëtar i Bordit në konflikt interesi do të përmbahet nga pjesëmarrja në çdo diskutim apo votim për çdo çështje apo vendim të Bordit.</p> <p>3. Bordi nuk do t'i zbulojë ose t'i japë një anëtar me konflikt interesi, informacion në lidhje me diskutimin apo t'i japë të drejtën për të votuar për një temë të caktuar. Abstenimi nga votimi nuk do të kualifikohet si reduktim i kuorumit.</p> <p>4. Në rast se një anëtar është gjetur se ka votuar në konflikt interesi, Kryesuesi do të deklarojë votimin të pavlefshëm dhe ri-vendos çështjen për diskutim dhe votim nga anëtarët tjerë të Bordit.</p> | <p>2. Every Board member in conflict of interest shall refrain from participation to any discussions or voting on any matters or decisions of the Board.</p> <p>3. The Board shall not disclose or give to a member with conflict of interest, information related to discussion or to give the right to vote on specific subject. Abstaining from voting will not be qualified as reduction of quorum.</p> <p>4. In case a member is found voting being in conflict of interest, the Chairman shall declare voting null and void, reschedule matter for discussion and voting by other Board members.</p> | <p>2. Svaki član Odbora koji je u sukobu interesa će se uzdržati od učešća u diskusiji ili glasanja o svim pitanjima ili odluke Odbora.</p> <p>3. Odbor ne može otkriti ili dati informaciju jednom članu koji se nalazi u sukobu interesa, u vezi sa diskusijom ili dati pravo glasa za određenu temu. Uzdržavanje od glasanja neće se kvalifikovati kao smanjenje kvoruma.</p> <p>4. Ako se ustanovi da je glasao član koji se nalazi u sukobu interesa, predsedavajući će proglasiti glasanje nevažećim i ponovo postaviti pitanje za diskusiju i glasanje od strane drugih članova Odbora.</p> |
| <p>Neni 14 Procesverbali</p> | <p>Article 14 Minutes</p> | <p>Član 14 Zapisnik</p> |
| <p>1. Me mbikëqyrjen e Drejtorit, Sekretariati do të mbajë procesverbalin e çdo mbledhjeje, do të mbajë të dhënat dhe përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me mbledhjet e Bordit.</p> <p>2. Të gjitha vendimet e marra nga Bordi do të regjistrohen nga Sekretariati në "Regjistrin e Takimeve" të Bordit. Me mbikëqyrjen e Drejtorit, procesverbali i takimit do të hartohet</p> | <p>1. Under the Director's supervision, the Secretariat shall maintain minutes of every meeting, collect information and prepare necessary documents for the Board's meeting.</p> <p>2. All copies of decisions received from the Board shall be registered by the Secretariat in the "Meetings' Register" of the Board. Under the Board's supervision, minutes of the meeting</p> | <p>1. Sa nadzorom direktora, Sekretarijat vodi zapisnik o svakom sastanku, vodi evidenciju i priprema svu potrebnu dokumentaciju vezanu za sednice Odbora.</p> <p>2. Sve odluke donete od strane Odbora registruju se od strane Sekretarijata u "Registar sastanaka" Upravnog odbora. sa nadzorom direktora, Sekretarijat sastavlja zapisnik sa sastanka, što je</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>nga Sekretariati sa më shpejt të jetë e mundur, dhe të miratohet dhe nënshkruhet nga Kryesuesi.</p> <p>3. Kopjet e procesverbalit të nënshkruar u dërgohen të gjithë anëtarëve të Bordit, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe të paktën tre (3) ditë para mbledhjes së ardhshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Mbajtja e të Dhënave</p> <p>1. Procesverbali, së bashku me të gjitha materialet e dorëzuara ose të përgatitura gjatë dhe pas takimeve të Bordit, do të arkivohen dhe referencohet me numra, së bashku me materialet tjera të përdorura nga Bordi. Regjistri i dokumenteve të Bordit do të mbahet nga Sekretariati, në emër të Bordit.</p> <p>2. Me përjashtim të dokumenteve konfidenciale, regjistri i dokumenteve të Bordit do të jetë në dispozicion të publikut.</p> | <p>shall be drafted by the Secretariat as soon as possible, and shall be adopted and signed by the Chairman.</p> <p>3. Copies of the signed minutes shall be sent to all members of the Board as soon as possible, and minimum three (3) days before the next meeting.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Maintenance of data</p> <p>1. Minutes along with all materials submitted or prepared during and after the Board's meetings shall be archived and referenced with numbers together with other materials used by the Board. The Register of Board's documents shall be maintained by the Secretariat, on the Board's behalf.</p> <p>2. With exception to confidential documents, the register of the Board's documents shall be available for the public.</p> | <p>pre moguće, koji predsedavajući usvaja i potpisuje.</p> <p>3. Kopije potpisanih zapisnika se dostavljaju svim članovima Upravnog odbora, u što kraćem roku, najmanje tri (3) dana pre sledećeg sastanka.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Čuvanje podataka</p> <p>1. Zapisnik, zajedno sa svim dostavljenim ili pripremljenim materijalima tokom i nakon sastavka se arhivira uz referentne brojeve, zajedno sa drugim materijalima koji se koriste od strane Odbora. Sekretarijat, u ime Odbora održava registar dokumenata.</p> <p>2. Uz izuzetak konfidencijalnih dokumenata, registar dokumenata Odbora će biti na raspolaganju javnosti.</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 16 Drejtori i Fondit</p> <p>1. Drejtori i Fondit është përgjegjës për funksionimin e përditshëm dhe menaxhimin e punës së Fondit.</p> <p>2. Drejtori zgjedhet për një mandat prej pesë (5) vjet, me mundësi ri-zgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.</p> | <p style="text-align: center;">Article 16 Director of the Fund</p> <p>1. The Director of the Fund is responsible for daily functioning and management of the Fund’s work.</p> <p>2. The Director is appointed with a mandate of five (5) years, with possible reappointment for one mandate more.</p> | <p style="text-align: center;">Član 16 Direktor Fonda</p> <p>1. Direktor Fonda je odgovoran za svakodnevno funkcionisanje i menadžiranje poslova Fonda.</p> <p>2. Direktor se bira za mandat od pet (5) godina, uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 17 Detyrat e Drejtorit të Fondit</p> <p>1. Drejtori i Fondit përveç detyrava të përapara me nenin 32 të Ligjit për Sigurime shëndetësore, kryen edhe këto detyra:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Propozon Bordit planin pesë (5) vjeçar strategjik të Fondit, planin vjetor të prokurimit dhe strategjinë e investimeve kapitale;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Vendosë mbi numrin, përdorimin, dhe autorizimin e një personi për përdorimin dhe ruajtjen e vulës së Fondit, në përputhje me Ligjin për Vulat e Institucioneve të Republikës së Kosovës.</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Propozon Bordit themelimin e degëve regjionale të Fondit;</p> | <p style="text-align: center;">Article 17 Duties of the Director of the Fund</p> <p>1. The Director of the Fund except duties foreseen in Article 32 of the Law on Health Insurance he also performs the following tasks:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Proposes the Board a five (5) year strategic plan of the Fund, annual procurement plan and strategy of capital investments;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Decide for number, use and authorization of a person to use and maintain stamp of the Fund, in accordance with Law on Institutional stamps of the Republic of Kosovo.</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Proposes the Board to establish regional branches of the Fund;</p> | <p style="text-align: center;">Član 17 Dužnosti direktora Fonda</p> <p>1.Direktor Fonda osim zadataka predviđenih u članu 32 Zakona o Zdravstvenom Osiguranju, obavlja i sledeće zadatke:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Odboru petogodišnji (5) strateški plan Fonda , godišnji plan za nabavke i strategiju kapitalnih investicija;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Odlučuje o broju, upotrebi i ovlašćenju lica za upotrebu i čuvanje pečata Fonda, u skladu sa Zakonom o pečatima institucija Republike Kosova;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.predlaže odboru osnivanje regionalnih ogranaka Fonda;</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.4.Negocion dhe lidhë kontratat me vlerë deri në 500,000 euro me ofruesit e kujdesit shëndetësor të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, bazuar në Ligjin për Sigurimin Shëndetësor;</p> <p>1.5.Nënshkruan kontrata me ofruesit e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kontratat me vlere mbi 500,000 euro, pas marrjes së vendimit nga Bordi;</p> <p>1.6.Raporton Bordit në lidhje me zbatimin e të gjitha kontratave;</p> <p>1.7.Emëron anëtarët e Komitetit Teknik për hartimin dhe përditësimin e Listës së shërbimeve themelore të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë Listën e barnave të rimbursueshme.</p> <p>1.8.Mbikëqyrë kontabilitetin e Fondit;</p> <p>1.9.Lidhë, ndryshon dhe të anulon kontratat e punës të punëtorëve të Fondit, duke përfshirë kontratat e shefave të degëve regionale;</p> <p>1.10.Propozon pagat e punëtorëve të Fondit në bazë të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes së Fondit të parashikuar në buxhetin e miratuar nga Bordi;</p> | <p>1.4.Negotiates and enters contracts valued up to 500,000 euro with health care provider licensed by the Ministry of Health, pursuant to Law on Health Insurance;</p> <p>1.5.Signs contracts with health care provider, including contracts valued over 500,000 euro after receiving Board decision;</p> <p>1.6.Reports to the Board on implementation of all contracts;</p> <p>1.7.Appoints members of the Technical Committee to draft and update list of basic health care services, including list of reimbursable medicaments.</p> <p>1.8.Supervises the Fund's accounting;</p> <p>1.9.Enters, amends and terminates employment contracts with the Fund's employees, including contracts for heads of regional branches;</p> <p>1.10.Proposes salaries for the Fund's employees pursuant to cost of operation and maintenance of the Fund, foreseen with the budget adopted by the Board;</p> | <p>1.4.Pregovara i zaključuje ugovore u vrednosti do 500,000 evra sa pružaocima usluga zdravstvene zaštite koji su licencirani od strane Ministarstva Zdravstva, na osnovu Zakona o Zdravstvenom Osiguranju.</p> <p>1.5.Potpisuje ugovore sa pružaocima usluga zdravstvene zaštite, uključujući ugovore u iznosu preko 500,000 evra , nakon odluke Odbora;</p> <p>1.6.Podnosi izveštaj Odboru u vezi sa sprovođenjem svih ugovora;</p> <p>1.7.Imenuje članove Tehničkog komiteta za izradu i ažuriranje Liste osnovnih zdravstvenih usluga, uključujući Listu za refundiranje lekova;</p> <p>1.8.Nadgleda računovodstvo Fonda;</p> <p>1.9.Zaključuje ,menja i poništava ugovore o radu zaposlenih u Fondu, uključujući ugovore rukovodioca regionalnih ogranaka;</p> <p>1.10.Predlaže plate za radnike Fonda na osnovu operativnih troškova i održavanja Fonda, predviđenih usvojenim budžetom od strane Odbora;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.11.Cakton dhe mbikëqyrë stafin për marrjen e shënimeve për mbledhjet e Bordit;</p> <p>1.12.Vendosë për çështje të tjera në kompetencën e Drejtorit në bazë të Ligjit për Sigurim Shëndetësor, këtë Statut dhe vendimet e Bordit.</p> | <p>1.11.Appoints and supervises staff to take notes for the Board’s meetings;</p> <p>1.12.Decides on other matters under the competency of the Director, pursuant to Law on Health Insurance, this Statute and the Board’s decisions.</p> | <p>1.11.Određuje i nadzire osoblje za uzimanje podataka za sastanke Odbora;</p> <p>1.12.Donosi odluke o ostalim pitanjima u nadležnosti direktora na osnovu Zakona o zdravstvenom osiguranju, Statuta i odluka Odbora.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 18 Degët Regjionale dhe Kontratat e Punës</p> | <p style="text-align: center;">Article 18 Regional branches and Contracts of Employment</p> | <p style="text-align: center;">Član 18 Regionalni ogranci i ugovori o radu</p> |
| <p>1. Degët regjionale të Fondit, selitë dhe përgjegjësitë e tyre do të rregullohen me vendim të Bordit, me propozimin e Drejtorit.</p> <p>2. Kontratat e punës së përgjegjësve të degëve regjionale të Fondit do të lidhen për një periudhë të caktuar deri në pesë (5) vjet, me mundësi vazhdimi.</p> | <p>1. The Fund’s regional branches, their seats and responsibilities shall be regulated by the Board’s decision, under the Director’s proposal.</p> <p>2. Contracts of Employment with heads of the Fund’s regional branches will be entered for a fixed term of five (5) years with possible extension.</p> | <p>1. Regionalni ogranci Fonda, njihova sedišta i odgovornosti se uređuju odlukom Odbora, na predlog direktora.</p> <p>2. Ugovori o radu sa odgovornim licima regionalnih ogranaka Fonda se zaključuju na određeno vreme do pet (5) godina, uz mogućnost produženja.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 19 Shpërbërja e Fondit</p> <p>1. Fondi mund të shpërbëhet vetëm me ligj të veçantë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës</p> | <p style="text-align: center;">Article 19 Dissolution of the Fund</p> <p>1. The Fund may be dissolved only under a special law adopted by the Assembly of Republic of Kosovo.</p> | <p style="text-align: center;">Član 19 Raspuštanje Fonda</p> <p>1. Fond se može raspustiti samo posebnim zakonom usvojenim od strane Skupštine Republike Kosova.</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>2. Pas shpërbërjes së Fondit, asetet e mbetura do të transferohen në pronësi të shtetit përveç nëse parashihet ndryshe në ligjin e veçantë mbi shpërbërjen e Fondit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Dispozitat Kalimtare</p> <p>Me themelimin e Fondit, punonjësit e Agjencionit të Financimit të Shëndetësisë, do të transferohen në pozita të përshtatshme në Fond, me anë të një vendimi të Ministrit të Shëndetësisë</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Hyrja në Fuqi</p> <p>Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë nga data e nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <p style="text-align: center;">_____ Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: center;">08 Dhjetor 2016</p> | <p>2. After dissolution of the Fund, the remaining assets will be transferred in the state ownership, except if provided otherwise by a special law on dissolution of the Fund.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Transitional provisions</p> <p>By establishment of the Fund, employees of the Health Financing Agency will be transferred into adequate positions in the Fund, by a decision of the Minister of Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Entry into Force</p> <p>This Statute shall enter into force seven (7) days from the date of signing by the Prime minister of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <p style="text-align: center;">_____ Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: center;">08 December 2016</p> | <p>2. Nakon raspuštanja, preostala imovina Fonda prenosi se u državno vlasništvo, osim ako nije drugačije predviđeno posebnim zakonom u vezi sa raspuštanjem Fonda.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Prelazne odredbe</p> <p>Osnivanjem Fonda, odlukom ministra zdravstva, zaposleni u Agenciji zdravstvenog finansiranja će biti prebačeni na odgovarajuće pozicije u Fondu.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj Statut stupa na snagu sedam (7) dana od dana potpisivanja od strane Premijera Republike Kosova.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <p style="text-align: center;">_____ Premijer Republike Kosovo</p> <p style="text-align: center;">08 Decembar 2016</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| | | |
|--|--|--|